

Procesverbal- Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Pajisja me infrastrukturë mbrojtëse dhe sinjalistikë rrugore Qeparo fshat, Sasaj Piqeras, rruga hyrëse Ilias”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): 34992200-9.

Vlera e fondit limit: 20 833 311.56 (njëzetëmilion e tetëqindetridhjetetremijë e treqind e njëmbëdhjetë pikë pesëdhjetegjashtë) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale të vlefshme për realizimin e objektit të kontratës, e lëshuar nga organi kompetent përkatës për kategorinë: N.S – 6/A (Sinjalistika rrugore jondriçuese)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) *përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*

c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, nenin 40, pika 5, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”.

Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 milion lekë për kategoritë e punimeve, është zgjedhur niveli i klasifikimit ”A” që i përgjigjet kësaj vlere.

Ky kriter është vendosur në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e punimeve që do të realizohen në kuadër të kësaj kontrate, si dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik dhe licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit dhe infrastrukturës rrugore.

Objekti i prokurimit parashikon vendosjen e elementëve të sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale, si dhe elementëve të infrastrukturës mbrojtëse rrugore në segmente me rëndësi për qarkullimin dhe sigurinë rrugore, konkretisht në zonat Qeparo Fshat, aksin Sasaj–Piqeras dhe rrugën hyrëse të Iliasit. Këto ndërhyrje kërkojnë njohuri teknike të specializuara, standarde të certifikuara zbatimi dhe eksperiencë në instalimin e sinjalistikës sipas normave teknike të sigurisë rrugore.

Kategoria e licencës N.S – 6/A mbulon specifikisht punimet e sinjalistikës rrugore jondriçuese dhe është drejtpërdrejt e lidhur me natyrën e kontratës, pasi garanton që operatori ekonomik disponon kapacitetin teknik, profesional dhe organizativ për realizimin korrekt të këtyre punimeve.

Vendosja e këtij kriteri synon garantimin e cilësisë dhe standardeve teknike të punimeve, sigurimin e zbatimit të punimeve nga operatorë të specializuar dhe të licencuar, rritjen e sigurisë rrugore për përdoruesit e akseve objekt ndërhyrjeje, shmangien e risqeve që mund të vijnë nga realizimi i punimeve nga subjekte të pakualifikuara dhe përputhshmërinë e plotë me kërkesat teknike dhe ligjore në fuqi.

Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe nuk cënon konkurrencën, pasi kërkesa për licencën N.S – 6/A përbën një detyrim standard për operatorët ekonomikë që ushtrojnë aktivitet në fushën e sinjalistikës rrugore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a dhe nenin 47 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes

tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar*”. Në rastin konkret, nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2023, 2024 dhe 2025 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji*”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenin 14 të Ligjit Nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvoja e suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë përvojë të suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme, duke paraqitur një nga alternativat e mëposhtme:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm, me një vlerë jo më të vogël se 45 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe të deklaruara në organet tatimore;

ose

b) Punë të ngjashme, ku vlera totale monetare e punëve të realizuara gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe të deklaruara në organet tatimore.

Përmbushja e njërit prej kushteve të mësipërme e bën ofertën të kualifikueshme.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, kërkohen si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore si dhe situacioni përfundimtar dhe akt kolaudimi

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën” nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 35 % të vlerës së fondit limit.

Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është mbi kufirin e lartë monetar.

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.1 është vendosur në funksion të garantimit të kapacitetit teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë që marrin pjesë në procedurën e prokurimit, me qëllim sigurimin e realizimit me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Kërkesa për paraqitjen e punëve të ngjashme për një kontratë të vetme në masën 45% të fondit limit; ose për kontrata të ngjashme me vlerë totale sa dyfishi i fondit limit, është në përputhje me nevojën e autoritetit kontraktor për të verifikuar se operatori ekonomik disponon eksperiencë praktike në realizimin e punimeve të natyrës së ngjashme, kapacitet organizativ dhe Teknik, burime njerëzore dhe logjistike si dhe aftësi për menaxhimin dhe përfundimin e kontratave brenda standardeve të kërkuara.

Ky kriter synon të minimizojë riskun e mosrealizimit të kontratës, vonesave në ekzekutimin e punimeve, mangësive teknike gjatë zbatimit dhe problematikave që lidhen me cilësinë e punimeve. Përcaktimi i eksperiencës gjatë pesë viteve të fundit konsiderohet i arsyeshëm, pasi garanton që operatori ekonomik ka eksperiencë të freskët dhe aktuale, është aktiv në treg, dhe disponon kapacitete operative funksionale në kohën e zhvillimit të procedurës.

Gjithashtu, kërkesa për dokumentacion mbështetës, si vërtetimet e realizimit të kontratave, faturat tatimore të deklaruara, situacioni përfundimtar, dhe akt kolaudimi shërben për të provuar jo vetëm ekzistencën e kontratave, por edhe realizimin real dhe përfundimin me sukses të tyre. Këto dokumente ndihmojnë autoritetin kontraktor në verifikimin e saktësisë së deklarimeve, shmangien e referencave fictive, dhe garantimin e transparencës dhe besueshmërisë së eksperiencës së paraqitur.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikata të vlefshme të lëshuara nga organizma të akredituar, si më poshtë:

- *SSH/EN ISO 9001:2015 – Sistemi i menaxhimit të cilësisë/ose ekuivalent;*
- *SSH/EN ISO 14001:2015 – Sistemi i menaxhimit mjedisor/ose ekuivalent;*
- *SSH/EN ISO 45001:2018 – Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë/ose ekuivalent;*
- *SSH/EN ISO 39001:2012 – Sistemi i menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor/ose ekuivalent,*
në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kjo kërkesë është në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të

VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

ISO 9001:2015 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë: Kjo certifikatë siguron që operatori ekonomik ka të implementuara procedura të standardizuara për kontrollin e cilësisë në të gjitha fazat e aktivitetit, duke përfshirë projektimin, prodhimin, furnizimin dhe instalimin e sinjalistikës rrugore. Në një sektor ku gabimet apo devijimet nga standardet mund të sjellin pasoja të rënda, një sistem i menaxhimit të cilësisë është i domosdoshëm për të garantuar përputhshmëri me specifikimet teknike dhe jetëgjatësi të produkteve të instaluar.

ISO 14001:2015 – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor: Sinjalistika rrugore përfshin përdorimin e materialeve si bojëra, solventë, materiale reflektuese dhe struktura metalike, të cilat mund të kenë ndikim në mjedis. Kjo certifikatë garanton që operatori ekonomik identifikon, monitoron dhe minimizon ndikimet mjedisore të aktivitetit të tij, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në projekte infrastrukturore që zhvillohen në hapësira publike.

ISO 45001:2018 – Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë: Zbatimi i sinjalistikës rrugore shpesh kryhet në kushte pune me rrezik të shtuar, si në rrugë me trafik aktiv, në kushte atmosferike të ndryshme apo në orare të zgjatura pune. Kjo certifikatë garanton që operatori ekonomik ka politika dhe procedura efektive për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve në punë, duke mbrojtur punonjësit, përdoruesit e rrugës dhe palët e treta.

ISO 39001:2012 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor: Kjo certifikatë është veçanërisht e rëndësishme për objektin konkret të prokurimit, pasi lidhet drejtpërdrejt me përmirësimin e sigurisë rrugore dhe reduktimin e aksidenteve. Operatorët ekonomikë të certifikuar sipas këtij standardi kanë të implementuara praktika dhe procedura që synojnë minimizimin e rreziqeve në trafik, duke përfshirë planifikimin e duhur të ndërhyrjeve në rrugë, vendosjen korrekte të sinjalistikës dhe respektimin e standardeve të sigurisë rrugore.

Kërkesa që certifikatat të jenë të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë të njohur nga Republika e Shqipërisë, garanton vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre. Kjo shmang paraqitjen e certifikatave jo të besueshme dhe siguron që operatorët janë audituar nga trupa të pavarura dhe kompetente.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të disponojë stafin teknik si më poshtë:

Një inxhinier ndërtimi, i diplomuar në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili infrastrukturë transporti.

Një inxhinier mekanik, i cili të ketë eksperiencë ose trajnim të provueshëm në fushën e sinjalistikës dhe sigurisë rrugore.

Dy punonjës për realizimin e vijëzimeve në asfalt, të pajisur me dëshmi ose certifikatë kualifikimi përkatëse.

Dhjetë punëtorë të thjeshtë.

Një punonjës i certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”.

Ky kriter do të përmbushet nga operatori ekonomik nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të paraqesë dokumentacionin provues për stafin teknik, përfshirë diplomat për inxhinierët, dëshmitë/certifikatat e kualifikimit për punonjësit përkatës, kontratat e vlefshme të punës, si dhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore, me qëllim vërtetimin e kualifikimit dhe marrëdhënies së punësimit. Ky dokumentacion duhet të dorëzohet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 40, pika 5/b, c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) ku parashikohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës, c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;”.

Kërkesa për disponimin e stafit teknik të përcaktuar në kriterin 3.4 është e domosdoshme, e justifikuar dhe drejtpërdrejt e lidhur me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës, e cila ka si objekt realizimin e punimeve të sinjalistikës rrugore, përfshirë vijëzimet horizontale në asfalt dhe vendosjen e elementeve të sinjalistikës vertikale. Ky lloj objekti prokurimi përbën një ndërhyrje me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë rrugore, orientimin e trafikut dhe mbrojtjen e jetës së përdoruesve të rrugës, ndaj kërkon domosdoshmërisht kapacitete njerëzore të kualifikuara dhe të specializuara.

Kriteri i kualifikimit për stafin teknik është hartuar në funksion të natyrës, kompleksitetit dhe rëndësisë së punimeve objekt prokurimi, të cilat lidhen drejtpërdrejt me sigurinë rrugore, orientimin e trafikut dhe garantimin e standardeve teknike në infrastrukturën rrugore. Punimet e parashikuara në preventiv përfshijnë realizimin e vijëzimeve horizontale me bojë bikomponente, furnizimin dhe vendosjen e tabelave të sinjalistikës vertikale, instalimin e përvijuesve rrugorë, montimin e barrierave mbrojtëse metalike guardrail, si dhe instalimin e ndriçimit rrugor LED me sistem fotovoltaiik dhe pajisje ndihmëse. Këto procese pune kërkojnë jo vetëm fuqi punëtore, por edhe staf teknik të specializuar dhe të kualifikuar për të garantuar realizimin e tyre sipas standardeve teknike dhe normave të sigurisë në fuqi.

Kërkesa për disponimin e një inxhinieri ndërtimi të profilit Infrastrukturë Transporti është e domosdoshme pasi ky specialist ka formimin profesional të nevojshëm për interpretimin dhe zbatimin e projekteve të infrastrukturës rrugore, për kontrollin teknik të punimeve dhe për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me standardet e projektimit dhe zbatimit të sinjalistikës rrugore. Punimet objekt kontrate lidhen me elementë të sigurisë së trafikut dhe kërkojnë njohuri specifike mbi parametrat teknikë të vijëzimeve horizontale, pozicionimin dhe distancat e sinjalistikës vertikale, si dhe koordinimin e punimeve në aks rrugor. Për më tepër, ky inxhinier është i nevojshëm për organizimin teknik të punimeve, kontrollin e cilësisë së materialeve dhe ndjekjen e zbatimit sipas specifikimeve teknike të preventivit dhe projektit. Duke qenë se punimet zhvillohen në infrastrukturë rrugore aktive dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë e qarkullimit, kërkesa për këtë profil është plotësisht e lidhur me objektin e kontratës dhe proporcionalisht e nevojshme.

Kërkesa për një inxhinier mekanik me eksperiencë ose trajnim të provueshëm në fushën e sinjalistikës dhe sigurisë rrugore justifikohet nga natyra e elementëve metalikë dhe mekanikë që përfshihen në këtë kontratë. Punimet parashikojnë furnizimin dhe montimin e barrierave mbrojtëse metalike guardrail H1, shtyllave të tabelave rrugore, përvijuesve modularë të kthesave, përvijuesve anësorë, si dhe shtyllave të ndriçimit LED me sistem diellor. Këto elementë kërkojnë njohuri specifike mbi karakteristikat mekanike të materialeve, mënyrën e montimit, rezistencën strukturore, ancorimin dhe qëndrueshmërinë e tyre në kushte atmosferike dhe gjatë ekspozimit ndaj ngarkesave dinamike të trafikut rrugor. Inxhinieri mekanik garanton që instalimi i këtyre elementëve të realizohet në mënyrë të sigurt dhe sipas parametrave teknikë të përcaktuar në standardet për sigurinë rrugore dhe elementët metalikë mbrojtës. Për më tepër, eksperiencia ose trajnimi në sinjalistikë rrugore siguron që ky specialist të ketë njohuri konkrete mbi kërkesat teknike të sinjalistikës dhe elementëve të sigurisë së trafikut.

Kërkesa për dy punonjës të pajisur me dëshmi ose certifikatë kualifikimi për realizimin e vijëzimeve në asfalt është e nevojshme për shkak se vijëzimi horizontal me bojë bikomponente është një proces teknik që kërkon përdorim të pajisjeve të specializuara dhe njohuri praktike për aplikimin korrekt të materialeve. Punimet e vijëzimit duhet të realizohen me gjerësi, trashësi dhe reflektim sipas standardeve teknike, në mënyrë që sinjalistika horizontale të jetë funksionale, e dukshme dhe rezistente ndaj konsumimit nga trafiku dhe kushtet atmosferike. Përdorimi i bojës bikomponente kërkon respektim të parametrave të temperaturës, dozimit dhe kohës së aplikimit, si dhe përdorim korrekt të pajisjeve sprajt. Për këtë arsye, kërkohet që punonjësit të jenë të kualifikuar dhe të pajisur me dëshmi ose certifikatë përkatëse, me qëllim garantimin e cilësisë së punimeve dhe sigurisë së qarkullimit rrugor.

Numri minimal prej dhjetë punëtorësh të thjeshtë është përcaktuar në raport të drejtpërdrejtë me proceset konkrete të punës që do të realizohen në terren dhe nevojën për zhvillimin paralel të tyre përgjatë aksit rrugor. Konkretisht, për procesin e transportit dhe shkarkimit të materialeve nevojiten minimalisht 2 punëtorë, të cilët angazhohen në shkarkimin, sistemimin dhe shpërndarjen e materialeve në pikat e punës. Për hapjen e gropave, përgatitjen dhe betonimin e bazamenteve për tabelat dhe shtyllat metalike nevojiten minimalisht 2 punëtorë, të cilët kryejnë proceset e gërmimit, përgatitjes së betonit dhe sistemimit të bazamenteve. Procesi i montimit të barrierave mbrojtëse (guardrail), për shkak të peshës dhe dimensioneve të elementëve metalikë, kërkon minimalisht 3 punëtorë për transportimin, pozicionimin dhe montimin e tyre përgjatë aksit rrugor. Për vendosjen e përvijuesve rrugorë dhe asistencën gjatë procesit të vijëzimit horizontal nevojiten minimalisht 2 punëtorë, të cilët angazhohen në pozicionimin e elementëve dhe mbështetjen operative të procesit të vijëzimit. Ndërkohë, për sistemimin e kantierit, pastrimin e zonës së punimeve dhe kryerjen e proceseve të tjera ndihmëse në terren nevojitet minimalisht 1 punëtor.

Kërkesa për një punonjës të certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” është e domosdoshme për shkak se punimet do të zhvillohen në aks rrugor aktiv, ku ekziston rrezik i shtuar për aksidente si për punonjësit ashtu edhe për përdoruesit e rrugës. Ky specialist është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e masave të sigurisë në kantier, organizimin e sinjalizimit të përkohshëm gjatë punimeve, kontrollin e përdorimit të pajisjeve mbrojtëse personale dhe monitorimin e kushteve të punës sipas legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë. Prania e këtij personi është e nevojshme për të garantuar zhvillimin e punimeve në mënyrë të sigurt dhe për të minimizuar rreziqet gjatë realizimit të kontratës.

Në përfundim, kërkesat për stafin teknik janë të lidhura ngushtë me natyrën dhe specifikat e kontratës, janë të nevojshme për garantimin e realizimit cilësor dhe të sigurt të punimeve dhe janë në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Këto kërkesa nuk kufizojnë konkurrencën, por synojnë të sigurojnë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të disponojnë kapacitetet minimale profesionale, teknike dhe organizative për realizimin korrekt të punimeve të sinjalistikës dhe sigurisë rrugore.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet teknike si më poshtë:

- *Një makineri për aplikimin e bojës termoplastike (APV);*
- *Një makineri vijëzimi vetëlëvizëse me bojë bikomponente (paste);*
- *Një kamionçinë me kapacitet mbajtës jo më pak se 1.5 ton;*
- *Një kompresor i lëvizshëm;*
- *Një gjenerator;*
- *Dy sete semaforësh për kontrollin e trafikut;*
- *Një mjet për pastrimin e vijëzimeve/bojës ekzistuese;*
- *Një mjet transporti ATV – karrotrec me kapacitet mbajtës 2–2.5 ton.*

Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituara, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

Për mjetet që regjistrohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit, si dhe taksat vjetore, si dhe leja e transportit të mallrave brenda vendit për ato mjete për të cilat kërkohet pajisja me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

Për mjetet e marra me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit, si dhe leja e transportit të mallrave brenda vendit për ato mjete për të cilat kërkohet pajisja me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi. Mjetet duhet të shoqërohen me kontratë qiraje të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera, duhet të paraqiten aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Për mjetet dhe pajisjet që nuk regjistrohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre.

Për pajisjet teknike, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes ose kontratat e shitblerjes. Kur janë me qira, duhet të paraqiten kontratat noteriale të qirasë, si dhe faturat tatimore të shitjes ose kontratat e shitblerjes, sipas rastit. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me TVSH (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqërohen me kuponin tatimor.

Ky kriter do të përmbushet nga operatori ekonomik nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjeteve dhe makinerive, duhet të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 1/c, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), ku parashikohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion

apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

Ky lloj aktiviteti kërkon pajisje të specializuara, teknologji të dedikuar dhe kapacitet operativ në terren, pasi sinjalistika rrugore ndikon drejtpërdrejt në sigurinë e qarkullimit dhe në orientimin e përdoruesve të rrugës. Për këtë arsye, çdo mjet i kërkuar ka funksion të veçantë teknik dhe është i pazëvendësueshëm në procesin e realizimit të kontratës.

Kriteri për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike është përcaktuar në funksion të drejtpërdrejtë të natyrës së punimeve objekt prokurimi, të cilat përfshijnë realizimin e sinjalistikës horizontale dhe vertikale rrugore, vendosjen e elementëve të sigurisë rrugore, instalimin e barrierave mbrojtëse guardrail, montimin e ndriçimit rrugor LED me sistem fotovoltaik, si dhe punime ndihmëse të organizimit dhe sigurimit të trafikut gjatë zbatimit të kontratës. Duke qenë se këto punime kërkojnë procese teknologjike të specializuara dhe ndërhyrje në aks rrugor aktiv, disponimi i mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara konsiderohet i domosdoshëm për realizimin korrekt, cilësor dhe brenda afateve të kontratës.

Kërkesa për një makineri për aplikimin e bojës termoplastike (APV) justifikohet nga fakti se punimet e sinjalistikës horizontale kërkojnë përdorimin e pajisjeve profesionale për aplikimin uniform të materialeve sinjalizuese në sipërfaqen e asfaltit. Edhe pse preventivi përfshin vijëzim me bojë bikomponente, makineria APV është e nevojshme për realizimin e elementëve të veçantë të sinjalistikës horizontale dhe për garantimin e parametrave teknikë të vijëzimit, si trashësia, reflektueshmëria dhe rezistenca ndaj konsumimit nga trafiku dhe faktorët atmosferikë. Kjo pajisje siguron standardizim të procesit të aplikimit dhe rrit cilësinë dhe jetëgjatësinë e vijëzimeve rrugore.

Kërkesa për një makineri vijëzimi vetëlëvizëse me bojë bikomponente (paste) është drejtpërdrejt e lidhur me zërin e preventivit “Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 15 cm. Bikomponente (sprajt)”. Realizimi i këtij procesi kërkon pajisje të specializuara të afta për aplikimin e materialit bikomponent në mënyrë uniforme dhe sipas parametrave teknikë të kërkuar në standardet e sinjalistikës rrugore. Makineria vetëlëvizëse garanton vijueshmëri lineare, kontroll të saktë të trashësisë dhe gjerësisë së vijëzimit, si dhe efikasitet në realizimin e punimeve në segmente rrugore me gjatësi të konsiderueshme. Përdorimi i pajisjeve të zakonshme ose manuale do të cenonte cilësinë dhe parametrat teknikë të sinjalistikës horizontale.

Kërkesa për një kamionçinë me kapacitet mbajtës jo më pak se 1.5ton është e nevojshme për transportin e materialeve dhe pajisjeve në terren, duke përfshirë tabelat rrugore, shtyllat metalike, përvijuesit, elementët guardrail, pajisjet e vijëzimit, materialet e betonimit dhe aksesoret e ndriçimit LED. Për shkak të natyrës lineare të punimeve dhe nevojës për lëvizje të vazhdueshme përgjatë aksit rrugor, disponimi i një mjeteve transporti me kapacitet të përshtatshëm është i domosdoshëm për organizimin logjistik të punimeve dhe realizimin e tyre brenda afateve kontraktore.

Kërkesa për një kompresor të lëvizshëm lidhet me nevojën për përdorimin e pajisjeve pneumatike gjatë montimit të elementëve të sinjalistikës dhe sigurisë rrugore. Kompresori përdoret për pastrimin e sipërfaqeve para aplikimit të bojës, për funksionimin e pajisjeve të aplikimit, për montimin e elementëve metalikë dhe për procese të tjera teknike të nevojshme gjatë realizimit të punimeve. Duke qenë se punimet zhvillohen në terren dhe në pika të ndryshme të aksit rrugor, kompresori duhet të jetë i lëvizshëm për të garantuar fleksibilitet operacional dhe efikasitet gjatë zbatimit.

Kërkesa për një gjenerator është e domosdoshme pasi një pjesë e konsiderueshme e punimeve realizohet në terren të hapur, ku mund të mungojë furnizimi me energji elektrike. Gjeneratori siguron furnizimin me energji për pajisjet e vijëzimit, pajisjet elektrike të montimit, ndriçimin e përkohshëm të kantierit dhe pajisje të tjera ndihmëse të nevojshme për realizimin e punimeve. Disponimi i tij garanton vazhdimësinë e proceseve të punës pa ndërprerje dhe shmang vonesat në realizimin e kontratës.

Kërkesa për dy sete semaforësh për kontrollin e trafikut justifikohet nga fakti se punimet do të realizohen në aks rrugor aktiv dhe kërkojnë menaxhim të përkohshëm të qarkullimit për garantimin e sigurisë së përdoruesve të rrugës dhe të personelit të angazhuar në punime. Semaforët e përkohshëm janë të nevojshëm për organizimin e lëvizjes alternative të mjeteve gjatë realizimit të vijëzimeve, montimit të tabelave, guardrail-eve dhe elementëve të tjerë të sigurisë rrugore. Disponimi i dy seteve mundëson kontrollin e trafikut në të dy drejtimet e lëvizjes dhe garanton zhvillimin e sigurt të punimeve në segmente rrugore me qarkullim.

Kërkesa për një mjet për pastrimin e vijëzimeve ose bojës ekzistuese është drejtpërdrejt e lidhur me procesin e realizimit të sinjalistikës horizontale. Përpara aplikimit të vijëzimeve të reja është e nevojshme heqja ose pastrimi i vijëzimeve ekzistuese, në mënyrë që të sigurohet aderenca e materialit të ri dhe shmangia e mbivendosjeve që mund të krijojnë konfuzion për përdoruesit e rrugës. Ky proces kërkon pajisje specifike për fshirjen ose pastrimin mekanik të bojës ekzistuese pa dëmtuar shtresën asfaltike.

Kërkesa për një mjet transporti ATV – karrotrec me kapacitet mbajtës 2–2.5ton justifikohet nga nevoja për transportin dhe lëvizjen e pajisjeve, materialeve dhe elementëve të sigurisë rrugore në segmente ku qasja me mjete të zakonshme është e kufizuar ose ku kërkohet manovrim i shpejtë dhe fleksibël përgjatë aksit rrugor. Ky mjet është i nevojshëm për transportin e pajisjeve të sinjalistikës, përvijuesve, materialeve ndihmëse dhe elementëve të montimit në terren, sidomos gjatë punimeve lineare në segmente të ndryshme të rrugës.

Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit provues për mjetet dhe pajisjet teknike është e nevojshme për të garantuar se operatori ekonomik disponon realisht kapacitetet teknike të deklaruara dhe se mjetet janë të ligjshme, funksionale dhe të vlefshme për përdorim gjatë realizimit të kontratës. Dokumentacioni i kërkuar për mjetet e regjistruara në regjistrat publikë, përfshirë lejet e qarkullimit, certifikatat e kontrollit teknik, siguracionet dhe lejet e transportit, garanton përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe sigurinë e përdorimit të tyre. Ndërsa dokumentacioni për pajisjet në pronësi ose me qira siguron verifikimin e disponueshmërisë reale të pajisjeve për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës.

Në përfundim, mjetet dhe pajisjet teknike të kërkuara janë të lidhura ngushtë me natyrën dhe specifikat e punimeve të parashikuara në preventiv, janë të domosdoshme për realizimin cilësor dhe të sigurt të kontratës dhe respektojnë parimin e proporcionalitetit, pasi përfaqësojnë kapacitetet minimale teknike të nevojshme për realizimin e punimeve të sinjalistikës dhe sigurisë rrugore.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave/materialeve të përcaktuara në preventiv, ose nga distributori i autorizuar prej tij, që garanton furnizimin me të gjitha materialet e nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota identifikuese të prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar, përfshirë emrin e shoqërisë, adresën, numrin e kontaktit, adresën elektronike dhe faqen zyrtare të internetit.

Në rast se autorizimi lëshohet nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion provues që vërteton marrëdhënien zyrtare ndërmjet prodhuesit dhe distributorit të autorizuar.

Argumentimi: Ky kriter gjen mbështetje në pikat 2 dhe 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku është e cituar: *5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Punimet e parashikuara në preventiv konsistojnë në realizimin e vijëzimeve horizontale me bojë bikomponente, furnizimin dhe vendosjen e tabelave rrugore “Ndalim”, tabelave trekëndore paralajmëruese, sinjaleve të drejtimit interurban, përvijuesve modularë të kthesave, përvijuesve anësorë, barrierave mbrojtëse metalike guardrail H1, pllakave fosforishente metalike, si dhe montimin e shtyllave të ndriçimit LED me bateri, panel diellor dhe aksesoret përkatës. Të gjithë këta elementë përbëjnë pajisje dhe materiale të sigurisë rrugore që duhet të plotësojnë standarde specifike teknike dhe cilësore për të garantuar funksionalitetin, jetëgjatësinë dhe sigurinë e përdoruesve të rrugës.

Kërkesa për autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar është e domosdoshme për zërin “Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 15 cm. Bikomponente (sprajt)”, pasi bojërat bikomponente dhe materialet reflektuese që përdoren për vijëzime rrugore duhet të jenë të certifikuar dhe të prodhuara sipas standardeve teknike që garantojnë reflektueshmëri, rezistencë ndaj konsumimit, aderencë në asfalt dhe qëndrueshmëri ndaj kushteve atmosferike. Autorizimi nga prodhuesi garanton që materiali i furnizuar është origjinal, i kontrolluar dhe i përshtatshëm për përdorim në sinjalistikë rrugore.

Po kështu, zërat “F.V. tabelë rrethi ‘ndalim’ normal me $D = 60$ ”, “F.V. Tabela trekëndore normal me $A = 90$ ” dhe “F.V. Sinjalet e drejtimit interurban HxL normal 40x150” përfshijnë tabela rrugore reflektuese të cilat duhet të prodhohen sipas standardeve për sinjalistikën vertikale, duke garantuar dukshmëri ditën dhe natën, rezistencë ndaj rrezeve UV, lagështisë dhe korrozionit. Këto tabela janë elementë të rëndësishëm të sigurisë së trafikut dhe përdorimi i materialeve jo të certifikuar ose pa origjinë të verifikueshme mund të sjellë degradim të shpejtë të reflektueshmërisë dhe humbje të funksionit sinjalizues. Për këtë arsye, autorizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar është i nevojshëm për të garantuar origjinën dhe cilësinë e tyre.

Kërkesa justifikohet gjithashtu nga zërat “F.V. Përvijues modularë të kthesave (çiftë)” dhe “F.V. Përvijues normal anësor”, të cilët janë elementë orientues të sigurisë rrugore që duhet të kenë karakteristika specifike reflektuese dhe rezistencë mekanike ndaj goditjeve dhe kushteve atmosferike. Duke qenë se këto pajisje instalohen në zona me ekspozim të lartë ndaj faktorëve klimatikë dhe trafikut, është e nevojshme të garantohet që ato janë prodhuar sipas standardeve të sigurisë rrugore dhe furnizohen nga burime të autorizuar.

Në lidhje me zërin “F.Montim shtylle H=9 ml ndriçimi LED bashkë me baterinë, panelin diellor dhe gjithë aksesoret e nevojshëm”, kërkesa për autorizim është e nevojshme pasi sistemi i ndriçimit përfshin pajisje elektrike dhe elektronike të specializuara, si trupat LED, bateritë, panelet

fotovoltaike dhe kontrollorët elektronikë, të cilët duhet të jenë të certifikuar dhe të garantuar nga prodhues të autorizuar. Cilësia dhe origjina e këtyre pajisjeve ndikojnë drejtpërdrejt në performancën, jetëgjatësinë dhe sigurinë e sistemit të ndriçimit rrugor. Përdorimi i produkteve jo origjinale ose jashtë standardeve mund të shkaktojë defekte teknike, ulje të efikasitetit energjetik dhe mosfunksionim të sistemit.

Kërkesa për autorizim është gjithashtu e domosdoshme për zërin “F.V. Guardrail H1 anësore me 2 valëzime në 1 anë, E3 + aksesoret”, pasi barrierat mbrojtëse metalike janë elementë kritikë të sigurisë rrugore dhe duhet të përmbushin standarde specifike për rezistencën mekanike, absorbimin e energjisë gjatë impaktit dhe parametrat teknikë të sigurisë. Guardrail-et duhet të jenë të prodhuara sipas standardeve europiane ose ekuivalente dhe të shoqërohen me certifikime teknike për performancën dhe qëndrueshmërinë e tyre. Autorizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar garanton që produktet janë origjinale dhe përmbushin parametrat teknikë të kërkuar në projekt.

Edhe për zërin “F.V. Pllakë fosforishente metalike”, kërkesa është e justifikuar pasi këto elementë përdoren për orientim dhe sinjalizim në kushte të dukshmërisë së kufizuar dhe duhet të kenë cilësi të garantuar reflektuese dhe fosforishente, në mënyrë që të sigurojnë efektivitet maksimal në funksion të sigurisë rrugore.

Kërkesa që autorizimi të përmbajë të dhëna të plota identifikuese të prodhuesit ose distributorit të autorizuar, si emri i shoqërisë, adresa, kontaktet, posta elektronike dhe faqja zyrtare e internetit, është e nevojshme për të garantuar autenticitetin dhe verifikueshmërinë e dokumentacionit. Kjo i mundëson autoritetit kontraktor të verifikojë ekzistencën reale të subjektit që lëshon autorizimin dhe ligjshmërinë e marrëdhënies së furnizimit.

Në rastet kur autorizimi lëshohet nga distributori i autorizuar, kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit që vërteton marrëdhënien ndërmjet prodhuesit dhe distributorit është e nevojshme për të shmangur përdorimin e autorizimeve të pavlefshme ose të lëshuara nga subjekte pa lidhje zyrtare me prodhuesin. Ky dokumentacion garanton që furnizimi i materialeve do të realizohet në mënyrë të ligjshme dhe nga kanale të autorizuar tregtare.

Ky kriter është në përputhje të plotë me natyrën e objektit të prokurimit dhe zërat konkretë të preventivit, pasi synon të garantojë origjinën, cilësinë, standardet teknike dhe vazhdimësinë e furnizimit të materialeve dhe pajisjeve që do të përdoren në realizimin e punimeve të sinjalistikës dhe infrastrukturës mbrojtëse rrugore.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë të prodhuesit, ose fragmente katalogësh, si dhe/ose skeda teknike (datasheet) për të gjitha materialet dhe produktet objekt prokurimi, të parashikuara në preventiv.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të identifikojë qartë produktet e ofruara, duke përfshirë emërtimin tregtar, markën, modelin ose çdo element tjetër identifikues të tyre, në mënyrë që të mundësohet gjurmueshmëria e produktit dhe verifikimi i origjinës së tij.

Skedat teknike dhe/ose katalogët duhet të përmbajnë në mënyrë të plotë dhe të detajuar të gjitha karakteristikat teknike të produkteve, përfshirë parametrat funksionalë, fizikë dhe cilësorë, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Në rastet kur katalogët nuk përmbajnë të gjitha të dhënat teknike të kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion shtesë teknik nga prodhuesi, i cili plotëson informacionin e munguar.

Argumentimi: Ky kriter është bazuar në nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, si dhe pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është përcaktuar se: [...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: [...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].

Punimet objekt kontrate përfshijnë materiale dhe pajisje të specializuara të sigurisë rrugore, të cilat duhet të përmbushin standarde të caktuara teknike, funksionale dhe cilësore për të garantuar sigurinë e qarkullimit, jetëgjatësinë e produkteve dhe realizimin korrekt të investimit. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka nevojë të verifikojë paraprakisht karakteristikat teknike dhe origjinën e produkteve që operatorët ekonomikë propozojnë të përdorin gjatë realizimit të kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e katalogëve dhe skedave teknike lidhet drejtpërdrejt me zërin e preventivit “Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 15 cm. Bikomponente (sprajt)”, pasi materialet për vijëzimin horizontal duhet të kenë parametra teknike të verifikueshëm, si reflektueshmëria, rezistenca ndaj konsumimit, trashësia e aplikimit, koha e tharjes, aderenca në asfalt dhe qëndrueshmëria ndaj kushteve atmosferike. Këto karakteristika mund të verifikohen vetëm nëpërmjet dokumentacionit teknik të prodhuesit, i cili garanton se materiali i ofruar është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Po kështu, zërat “F.V. tabelë rrethi ‘ndalim’ normal me $D = 60$ ”, “F.V. Tabela trekëndore normal me $A = 90$ ” dhe “F.V. Sinjalet e drejtimit interurban HxL normal 40x150” përfshijnë tabela rrugore reflektuese që duhet të kenë parametra teknike të përcaktuar, si tipi i fletës reflektuese, niveli i reflektueshmërisë, trashësia e materialit metalik, rezistenca ndaj korrozionit dhe dimensionet sipas standardeve të sinjalistikës rrugore. Katalogët dhe datasheet-et janë të nevojshme për të verifikuar që produktet e ofruara përmbushin standardet teknike dhe cilësore të kërkuara për përdorim në infrastrukturë rrugore.

Kërkesa justifikohet gjithashtu nga zërat “F.V. Përvijues modularë të kthesave (çiftë)” dhe “F.V. Përvijues normal anësor”, pasi këto elementë duhet të kenë karakteristika të caktuara reflektuese, rezistencë mekanike ndaj goditjeve dhe qëndrueshmëri ndaj kushteve atmosferike. Vetëm nëpërmjet dokumentacionit teknik të prodhuesit mund të verifikohet cilësia dhe performanca e tyre teknike.

Në lidhje me zërin “F.Montim shtyllë H=9 m ndriçimi LED bashkë me baterinë, panelin diellor dhe gjithë aksesorët e nevojshëm”, paraqitja e katalogëve dhe skedave teknike është thelbësore për verifikimin e parametrave të pajisjeve elektrike dhe elektronike, si fuqia e ndriçimit LED, fluksi ndriçues, kapaciteti i baterisë, fuqia dhe eficientia e panelit fotovoltaik, shkalla e mbrojtjes IP, jetëgjatësia e pajisjeve dhe parametrat e funksionimit të sistemit. Duke qenë se këto elementë ndikojnë drejtpërdrejt në performancën dhe funksionalitetin e ndriçimit rrugor, Autoriteti Kontraktor duhet të ketë mundësi të verifikojë paraprakisht karakteristikat teknike të produkteve të ofruara.

Po kështu, për zërin “F.V. barrierë mbrojtëse (guardrail) H1 anësore me 2 valë në një anë, tip W3, + aksesorët”, katalogët dhe datasheet-et janë të domosdoshme për të verifikuar parametrat teknike të

barrierave mbrojtëse, si klasa e mbrojtjes H1, niveli i deformimit W3, trashësia e galvanizimit, dimensionet e profileve metalike dhe përputhshmëria me standardet për barrierat rrugore. Këto elementë janë kritikë për sigurinë rrugore dhe nuk mund të verifikohen vetëm nëpërmjet deklarimeve të operatorit ekonomik.

Kërkesa është e nevojshme edhe për zërin “F.V. Pllakë fosforishente metalike”, pasi këto produkte duhet të kenë parametra të matshëm të ndriçimit fosforishent, rezistencës ndaj kushteve atmosferike dhe jetëgjatësisë së materialit reflektues. Dokumentacioni teknik i prodhuesit i jep Autoritetit Kontraktor mundësinë të verifikojë në mënyrë objektive performancën dhe cilësinë e produkteve të propozuara.

Kërkesa që katalogët dhe skedat teknike të identifikojnë qartë produktet e ofruara, përfshirë emërtimin tregtar, markën, modelin ose elementë të tjerë identifikues, është e nevojshme për të garantuar gjurmueshmërinë e produkteve dhe verifikimin e origjinës së tyre. Kjo shmang paraqitjen e dokumentacionit të përgjithshëm ose të papërcaktuar dhe i mundëson Autoritetit Kontraktor të identifikojë saktësisht produktin që operatori ekonomik synon të përdorë gjatë realizimit të kontratës.

Po kështu, kërkesa që skedat teknike dhe katalogët të përmbajnë të gjitha karakteristikat teknike të produkteve është e nevojshme për të bërë të mundur vlerësimin objektiv të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të tenderit. Përmes këtij dokumentacioni, Autoriteti Kontraktor verifikon parametrat funksionalë, fizikë dhe cilësorë të produkteve dhe shmang riskun e përdorimit të materialeve nën standard ose jo në përputhje me kërkesat teknike të kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit shtesë teknik nga prodhuesi në rastet kur katalogët nuk përmbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme është gjithashtu e justifikuar, pasi siguron plotësimin e informacionit teknik dhe mundëson një proces të plotë dhe transparent verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me natyrën e punimeve dhe me materialet e parashikuara në preventiv, pasi synon të garantojë cilësinë, origjinën, përputhshmërinë teknike dhe gjurmueshmërinë e produkteve që do të përdoren në realizimin e punimeve të sinjalistikës dhe infrastrukturës mbrojtëse rrugore.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë në datën dhe orën e hapjes se prokurimit, mostër të produkteve: bojë bikomponente spray e bardhë, përvijues modularë të kthesave (çift), tabelë rrethi "ndalim" normal me $D = 60$, barrierë mbrojtëse (guardrail) H1 anësore me 2 valë në një anë, tip W3, + aksesorët.

Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë në datën dhe orën e hapjes se tenderit, me adresë: pranë stadiumit, Himarë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe pikën 6/a, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që

tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”.

Kërkesa për mostrën e bojës bikomponente spray e bardhë është e domosdoshme pasi ky material përbën bazën e sinjalistikës horizontale dhe ndikon drejtpërdrejt në dukshmërinë, reflektueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e vijëzimeve rrugore. Testimi fizik i mostrës i mundëson Autoritetit Kontraktor të verifikojë konsistencën, ngjyrën, cilësinë e aplikimit dhe karakteristikat e tharjes së materialit, duke garantuar që ai përmbush kërkesat teknike të parashikuara për përdorim në rrugë.

Kërkesa për mostrat e përvijuesve modularë të kthesave (çift) është e justifikuar, pasi këto elementë janë pjesë e sinjalistikës orientuese dhe mbrojtëse rrugore dhe duhet të kenë karakteristika të qarta reflektuese, rezistencë mekanike dhe dukshmëri në kushte të ndryshme ndriçimi. Paraqitja e mostrës mundëson verifikimin e cilësisë së materialit plastik ose metalik, fortësisë strukturore, si dhe performancës së elementëve reflektues në kushte reale.

Kërkesa për mostrën e tabelës rrethore “ndalim” me diametër 60 cm është gjithashtu e domosdoshme, pasi tabelat rrugore janë elementë kritikë të sigurisë së trafikut dhe duhet të përmbushin standarde të sakta për dimensionet, ngjyrat, simbolet, tipin e fletës reflektuese dhe cilësinë e materialit bazë. Testimi i mostrës i jep Autoritetit Kontraktor mundësinë të verifikojë dukshmërinë, cilësinë e printimit, reflektueshmërinë dhe përputhshmërinë me kërkesat teknike të sinjalistikës rrugore.

Kërkesa për paraqitjen e mostrës së barrierës mbrojtëse (guardrail) H1 anësore me 2 valë në një anë, tip W3, së bashku me aksesoret përkatës, është e nevojshme për të verifikuar përputhshmërinë e produktit që do të furnizohet me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara në dokumentet e procedurës. Duke qenë se barrierat mbrojtëse përbëjnë element sigurie rrugore me rëndësi të veçantë dhe ndikojnë drejtpërdrejt në mbrojtjen e përdoruesve të rrugës, autoriteti kontraktor duhet të sigurohet paraprakisht që materiali i propozuar plotëson kërkesat për rezistencë mekanike, cilësi prodhimi, mbrojtje ndaj korrozionit, dimensione standarde dhe kompatibilitet të plotë të elementëve përbërës. Paraqitja e mostrës mundëson verifikimin fizik të profilit me dy valë, trashësisë së materialit, cilësisë së galvanizimit, mënyrës së realizimit të vrimave teknologjike, elementëve lidhës dhe aksesoreve shoqërues, si dhe kontrollin e përputhjes së tyre me klasën e përmbajtjes H1 dhe tipologjinë W3 të kërkuar në projekt. Gjithashtu, mostra shërben për të vlerësuar cilësinë vizuale dhe teknike të produktit që do të instalohet në terren, duke shmangur furnizimin me materiale që nuk përmbushin parametrat e kërkuar ose që paraqesin ndryshime nga specifikimet teknike. Kjo kërkesë lidhet edhe me nevojën për garantimin e uniformitetit të elementëve të sigurisë rrugore dhe sigurimin e kompatibilitetit ndërmjet barrierës, shtyllave dhe aksesoreve të montimit, me qëllim realizimin korrekt të sistemit mbrojtës sipas standardeve

teknike të aplikueshme. Përmes mostrës, autoriteti kontraktor krijon mundësinë për të kryer një vlerësim paraprak teknik dhe cilësor të produktit që ofertuesi propozon të përdorë gjatë zbatimit të kontratës, duke minimizuar riskun e furnizimit me materiale nën standard dhe duke garantuar cilësinë, qëndrueshmërinë dhe sigurinë e investimit publik.

Paraqitja e mostrave në momentin e hapjes së tenderit siguron transparencë të plotë në procesin e vlerësimit dhe mundëson krahasimin objektiv midis ofertuesve jo vetëm në bazë të dokumentacionit, por edhe në bazë të cilësisë reale të produkteve të ofruara. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për kontrata që lidhen me sigurinë rrugore, ku cilësia e materialeve ndikon drejtpërdrejt në parandalimin e aksidenteve dhe në orientimin e sigurt të përdoruesve të rrugës.

Ky kriter gjithashtu garanton shmangien e produkteve jo cilësore ose të papërshtatshme për përdorim në infrastrukturë rrugore, duke reduktuar riskun e përdorimit të materialeve që nuk përmbushin standardet teknike të kërkuara. Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktor sigurohet që materialet e propozuara janë realisht të zbatueshme në terren dhe përputhen me specifikimet teknike të projektit.

Kërkesa për paraqitjen e mostrave është një masë e domosdoshme, proporcionale dhe e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e punimeve, pasi synon të garantojë cilësinë reale të materialeve, përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike dhe sigurinë e përdoruesve të rrugës gjatë dhe pas realizimit të projektit të sinjalistikës dhe infrastrukturës mbrojtëse rrugore.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të hartuara për këtë objekt janë përcaktuar në funksion të garantimit të sigurisë rrugore, qëndrueshmërisë afatgjatë të materialeve, reduktimit të kostove të mirëmbajtjes dhe përputhshmërisë me standardet europiane të sinjalistikës dhe infrastrukturës mbrojtëse rrugore. Duke qenë se segmentet rrugore të përfshira në projekt karakterizohen nga terren kodrinor dhe bregdetar, me kthesa të forta, lagështi të lartë, ekspozim intensiv ndaj rrezeve UV dhe mungesë të ndriçimit urban në disa zona, është e domosdoshme përdorimi i materialeve me performancë të lartë dhe jetëgjatësi të garantuar.

Për sinjalistikën horizontale është kërkuar bojë bikomponente spray me bazë plastikë të ftohtë “cold plastic”, pa tretës dhe me sistem aplikimi 98:2, pasi ky sistem përfaqëson teknologjinë më të avancuar për sinjalizimin rrugor me rezistencë të lartë ndaj trafikut intensiv dhe konsumimit mekanik. Përdorimi i materialit dy-komponentësh me bazë rrëshire metakrilike siguron polimerizim të kontrolluar, aderencë shumë të mirë me asfaltin dhe rezistencë të lartë ndaj deformimeve, konsumimit nga goma, frenimeve dhe kushteve atmosferike. Përmbajtja shumë e lartë e substancës solide minimizon tkurrjen e shtresës pas aplikimit dhe shmang emetimin e tretësve të dëmshëm, duke garantuar njëkohësisht trashësi reale funksionale dhe performancë të qëndrueshme në kohë.

Përdorimi i pigmentit dioksid titani TiO_2 është kërkuar për shkak të bardhësisë së lartë, reflektimit optimal dhe stabilitetit kromatik në ekspozim afatgjatë ndaj rrezeve ultraviolette. Trashësia e kërkuar e shtresës prej rreth 1.2–1.6 mm është e nevojshme për të garantuar jetëgjatësi të shtuar të sinjalistikës, mbajtje më të mirë të ruazave reflektuese dhe rezistencë më të lartë ndaj trafikut. Parametrat e kërkuar të performancës si klasat R4, RĒ3, Q5 dhe P7 janë përcaktuar për të garantuar dukshmëri maksimale ditën, natën dhe në kushte lagështie, si dhe rezistencë të lartë ndaj konsumimit në rrugë me trafik të vazhdueshëm.

Ruazat qelqi reaktive janë kërkuar me standard SSH EN 1423 pasi ato sigurojnë njëkohësisht retroreflektim dhe aktivizim të procesit të polimerizimit të materialit. Indeksi i thyerjes ≥ 1.5 dhe rrumbullakësia $\geq 80\%$ janë parametra të domosdoshëm për të garantuar reflektim të lartë të dritës dhe shpërndarje uniforme mbi shtresën e bojës. Kërkesa për veshje reaktive është thelbësore për aktivizimin korrekt të ngurtësimit të materialit bikomponent.

Kërkesa për certifikim sipas SSH EN 1436 dhe SSH EN 13197 nga laboratorë europianë të akredituar është vendosur për të garantuar se performanca e deklaruar është reale, e testuar dhe e verifikueshme sipas standardeve europiane të sigurisë rrugore. Kjo shmang përdorimin e materialeve jo cilësore dhe garanton që sinjalistika të përmbushë parametrat teknikë të kërkuar gjatë gjithë jetës së saj funksionale.

Për tabelat rrugore është kërkuar përdorimi i llamarinës së aliazhit të aluminit me trashësi jo më pak se 2.5 mm për shkak të rezistencës së lartë ndaj korrozionit, peshës së ulët dhe qëndrueshmërisë shumë të mirë në kushte atmosferike bregdetare. Trashësia e përcaktuar shmang deformimet nga era, vibrimet dhe ndryshimet termike. Bordurat e kthyera në të gjithë perimetrin e tabelës rrisin ngurtësinë strukturore dhe shmangin deformimet mekanike gjatë shërbimit.

Kërkesa për film reflektues të klasës RA2 sipas EN 12899-1 është përcaktuar për të garantuar dukshmëri të lartë në rrugë rurale dhe segmente pa ndriçim publik. Teknologjia mikroprizmatike HIP “High Intensity Prismatic” siguron reflektim shumë më të lartë se filmat standardë dhe përmirëson ndjeshëm lexueshmërinë e tabelave në distanca të mëdha dhe në kushte shiu apo mjegulle. Kërkesat për kromaticitetin, luminancën dhe retroreflektimin janë vendosur për të garantuar që tabelat të ruajnë parametrat optikë gjatë gjithë periudhës së përdorimit. Jetëgjatësia minimale prej 10 vitesh është kërkuar për të reduktuar kostot e mirëmbajtjes dhe për të siguruar performancë afatgjatë në përputhje me standardet europiane.

Bullonat antivandalizëm me kokë cilindrike dhe hegzagon të brendshëm janë kërkuar për të parandaluar çmontimet e paautorizuara dhe vjedhjet e elementeve të sinjalistikës, problematikë e zakonshme në infrastrukturën rrugore.

Përvijuesit modularë të kthesave dhe delineatorët anësorë janë kërkuar për të rritur orientimin vizual të drejtuesve të mjeteve në segmentet me kthesa të forta dhe në kushtet e mungesës së ndriçimit. Përdorimi i filmave reflektues të klasës HIP/Class 2 garanton dukshmëri shumë të lartë gjatë natës dhe përmirëson perceptimin e trajektores së rrugës. Materialet elastike HDPE/PVC janë zgjedhur për shkak të rezistencës ndaj goditjeve dhe aftësisë për rikthim në formën fillestare pas deformimeve të lehta. Përdorimi i elementëve inox A2 ose A4 është i domosdoshëm për të garantuar rezistencë ndaj korrozionit në zonat me lagështi dhe ndikim të aerosolëve detarë.

Pllakat fosforishente metalike janë kërkuar për të garantuar orientim dhe dukshmëri edhe në mungesë totale të energjisë elektrike. Kombinimi i shtresës fotolumineshente me filmin retroreflektues siguron funksionim të dyfishtë, duke reflektuar dritën e automjeteve dhe duke emetuar dritë të akumuluar gjatë natës. Autonomia 8–12 orë është përcaktuar për të mbuluar të gjithë periudhën e errësirës dhe për të rritur sigurinë në segmente rurale pa ndriçim.

Për sistemin e ndriçimit është kërkuar përdorimi i ndriçuesve autonomë LED me furnizim nga panele fotovoltaike për shkak të mungesës së rrjetit elektrik në disa zona dhe nevojës për minimizimin e kostove operative. Integrimi i panelit, baterisë dhe ndriçuesit në një trup të vetëm redukton rrezikun e vandalizmit dhe vjedhjes së komponentëve. Përdorimi i baterive LiFePO₄ është zgjedhur për shkak të jetëgjatësisë së lartë, sigurisë termike dhe rezistencës ndaj cikleve të shumta të karikim-shkarkimit. Parametrat IP65 dhe IK08 garantojnë mbrojtje ndaj ujit, pluhurit

dhe goditjeve mekanike. Efikasiteti i lartë energjetik prej 175 lm/Ë dhe sistemi inteligjent i errësimit sigurojnë autonomi të lartë dhe optimizim të konsumit energjetik.

Barrierat mbrojtëse metalike janë projektuar në përputhje me standardin EN 1317 për të garantuar performancë të testuar në kushte reale përplasjesh. Përdorimi i barrierave të klasës H1-Ë3 siguron nivel të përshtatshëm mbrojtjeje për rrugët interurbane dhe segmentet me rrezikshmëri të lartë. Çeliku S275JR është kërkuar për shkak të rezistencës së lartë mekanike dhe aftësisë për të përballuar deformime plastike të kontrolluara gjatë impaktit. Galvanizimi në të nxehtë është i domosdoshëm për të mbrojtur elementët nga korrozioni, sidomos në zonat bregdetare me lagështi dhe kripësi të lartë. Bulonat e klasës 8.8 garantojnë rezistencë të lartë në tërheqje dhe siguri strukturore gjatë përplasjeve.

Në përfundim, të gjitha specifikimet teknike të paraqitura janë hartuar në funksion të garantimit të një infrastrukture rrugore moderne, të sigurt, me jetëgjatësi të lartë dhe në përputhje të plotë me standardet europiane të sigurisë dhe performancës. Këto kërkesa sigurojnë cilësi të lartë të materialeve, reduktim të kostove të mirëmbajtjes, rritje të sigurisë së përdoruesve të rrugës dhe qëndrueshmëri afatgjatë të investimit publik.

NJËSIA E PROKURIMIT